



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS PËR VITIN 2021

**Prishtinë, qershor 2022**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Administratës Tatimore të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Administratës Tatimore të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ATK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Theksimi i Çështjes

- 1 ATK edhe gjatë vitit 2021 nuk kishte vënë në funksion sistemin e-pasuria, por që pasuritë jokapitale dhe stoqet janë të evidentuara në regjistër të brendshëm(Excel). Përmes procedurave të auditimit është konstatuar që vlera e pasurisë nën 1000€ dhe stoqeve ishte e saktë dhe e plotë dhe ishte prezantuar drejt në PFV.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Administratës Tatimore të Kosovës.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Administratës Tatimore të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Administratës Tatimore të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose

gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Administratës Tatimore të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme;
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm;
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti; dhe
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Administrata Tatimore e Kosovës ka arkëtuar rreth 28% të hyra më shumë krahasuar me vitin paraprak. Në kontekst të gjetjeve vërehet mungesë e kontrolleve në paisjen e bizneseve me arka fiskale, llogarive të arkëtueshme si dhe të auditimit të brendshëm.

Ky raport ka rezultuar me tre (3) rekomandime, prej tyre një (1) është rekomandim i ri, dhe dy (2) rekomandime janë të përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Të hyrat

Të hyrat tatimore të planifikuara me Ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021 ishin 520,200,000€. Ndërkaq, me ligjin e rishikuar të buxhetit, vlera e parashikuar e të hyrave tatimore ishte rritur në 556,000,000€.

Nga kjo vlerë, ATK kishte arritur të realizonte 597,702,804€, ndërsa në vlera neto, realizimi ishte 541,632,809€, (të hyrat bruto 597,702,804€ - 56,069,995€ kthimet). Krahasuar me vitin e kaluar, të hyrat bruto në përgjithësi kanë pësuar rritje. Në vitin 2021, realizimi i të hyrave bruto ishte më i lartë për 130,662,971€ apo rreth 28% më shumë se në vitin 2020. Burimet kryesore të të hyrave në ATK janë: tatimi në vlerën e shtuar, tatimi në të ardhurat personale, tatimi i mbajtur në burim dhe tatimi në të ardhurat e korporatave. Në kemi analizuar menaxhimin e procesit të të hyrave dhe rimbursimeve/kthimeve dhe nga ekzaminimet tona kanë rezultuar çështja në vijim:

#### Çështja B1 - Ngecje në pajisjen e bizneseve me arka fiskale

##### Gjetja

UA nr. 02/2018 për shfrytëzimin e pajisjeve elektronike dhe sistemeve fiskale neni 4, pika 1.1, specifikon se të gjithë personat që bëjnë furnizime të mallrave dhe/ose shërbimeve në objektet, njësitë ose vendet të cilat mund të jenë në qasje të publikut, janë të obliguar që të shfrytëzojnë pajisjet elektronike fiskale (PEF) dhe pajisjet tjera të obligueshme për regjistrimin dhe vërtetimin e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve.

Më tutje, neni 4, pika 3, sqaron se personi të cilit i referohet obligimi i përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni dhe i cili njëkohësisht kryen edhe aktivitete që nuk janë të përjashtuara ose të liruara nga detyrimi i regjistrimit përmes arkës fiskale dhe të transferimit të të dhënave përmes terminalit te serveri i ATK-së, në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, do të jetë i obliguar që çdo qarkullim individual gjatë kryerjes së këtyre aktiviteteve të regjistrojë përmes arkës fiskale si dhe t'i transferojë të dhënat përmes terminalit në server të ATK-së.

Ne kemi vërejtur që përkundër përpjekjeve të bëra nga ATK fiskalizimi i plotë i të gjitha bizneseve mbetet ende sfidë. Numri i bizneseve që nuk janë fiskalizuar ende e që sipas legjislacionit në fuqi kërkohet të pajisen me arka fiskale në fund të vitit 2021 ishte 13,656 tatimpagues. Pjesën më të madhe të tyre prej 9,794 biznese apo rreth 72% e përbëjnë mikro bizneset me qarkullim vjetor deri në 5,000€.

Arsyeja është rezistenca e vazhdueshme e bizneseve për pajisjen me arka fiskale për shkak kostos së pajisjeve me arkës fiskale mirëpo dhe problemet gjatë procesit të funksionalizimit të sistemit të ri për arka fiskale.

##### Ndikimi

Mos pajisja e tatimpaguesve me arka fiskale e rrit rrezikun për mungesën e informatave gjatë veprimtarive ekonomike si dhe mundësinë e evazionit tatimor. Gjithashtu, kjo rezulton me një konkurrencë jo të barabartë ndërmjet bizneseve që zhvillojnë aktivitete ekonomike.

**Rekomandimi B1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha bizneset të cilat i plotësojnë kriteret për fiskalizim do të pajisjen me pajisjet elektronike fiskale (PEF) sipas kërkesave ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.1.2 Të arkëtueshmet

ATK në PFV-të e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 433,954,238€, prej të cilave 214,431,328€ apo 49% janë tatim bazë 89,825,383€ apo 21%, janë ndëshkime dhe 129,697,526€ apo 30% janë shpenzime të interesit. Bazuar në llojin e tatimit, pjesëmarrjen më të madhe në totalin e llogarive të arkëtueshme e kanë: Tatimi mbi vlerën e shtuar, Tatimi në Korporata, Kontributet Pensionale, Tatimi për bizneset individuale, Tatimi në paga etj. Nga ekzaminimet tona kemi vërejtur çështjen në vijim:

### Çështja B2 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme/ borxheve të vjetra

**Gjetja** ATK për vitin 2021 në planin e punës kishte përcaktuar që të inkasohen borxhet në vlerë 146,561,209€. Po ashtu, në planin punës është paraparë ndërmarrja e iniciativave për të pastruar stokun e borxhit nga të gjitha borxhet e pa mbledhshme.

ATK nuk ka treguar efikasitet në mbledhjen e borxheve të vjetra apo në marrjen e ndonjë iniciative për të pastruar stokun e borxhit nga të gjitha borxhet e pa mbledhshme. Kjo çështje mbetet sfidë edhe për të ardhmen pasi që vlera e tij në fund të vitit 2021 ishte rritur në 96,140,956€, krahasuar me vlerën e tij në 2020 që ishte 78,206,361€.

Megjithatë gjatë vitit 2021 si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik në vend ATK kishte arkëtuar borxhet jo të vjetra në vlerë prej 134,813,165€ që krahasuar me vitin 2020 ku ishin mbledhur 97,563,764€ kishte një progres të rëndësishëm.

Sipas ATK-së rritja e stokut të borxhit të përgjithshëm është ndikuar nga borxhet e vjetra e të cilat vijnë kryesisht nga Ndërmarrjet Publik.

**Ndikimi** Niveli i ulët i arkëtimit të borxheve të vjetra rritë stokun e borxheve të akumuluar, të cilat me kalimin e kohës vjetërsohen dhe shndërrohen në borxhe të këqija dhe të pambledhshme.

**Rekomandimi B2** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime më efektive në inkasimin e këtyre borxheve. Për më tepër, përpjekje shtesë nevojiten në trajtimin e stokut të borxheve të vjetra bazuar në kërkesat ligjore përkatëse.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.1.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

ATK ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB), e cila operon me pesë anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe katër auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe rreziqet tjera të ATK. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte përgatitur planin vjetor ku kishte parapare të kryente dhjetë auditime. NjAB gjatë vitit 2021 kishte kryer edhe një auditim të mbetur nga viti paraprak. NjAB ka mbuluar kryesisht periudhën 2021 dhe raportet kishin rezultuar me gjithsej 53 rekomandime, prej të cilave 8 rekomandime janë zbatuar, 35 rekomandime janë në proces të zbatimit dhe 10 nuk janë zbatuar. Qasja e auditimit të brendshëm ishte e bazuar në rreziqet e veprimtarisë së ATK-së. Komiteti i Auditimit është i themeluar në kuadër të Ministrisë së Financave dhe mbulon të gjitha agjencitë e saj, përfshirë edhe ATK.

#### **Çështja A1 - Ushtrimi i detyrës së Drejtorit të AB-së në kundërshtim me vendimin e KPMSHC dhe ATK**

##### **Gjetja**

Bazuar në vendimin e KPMSHC nr. A 461/2021 të datës 23.06.2021, Drejtori i ATK-së ka nxjerr vendimin nr.186 me datë 09.07.2021 për risistemimin e Drejtorit të AB-së në pozitën e zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm.

Ne vërejtëm se edhe pas këtij vendimi (nga muaji korrik 2021 e deri në maj 2022) zëvendës drejtori i përgjithshëm ka vazhduar të kryej detyrat dhe funksionin e Drejtorit të NjAB-së. Gjatë periudhës korrik-dhjetor 2021 ai kishte nënshkruar 7 raporte të NjAB, si dhe kishte kryer raportin vjetor për NJQH AB në fund të vitit 2021.

Analizat e pamjaftueshme të proceseve që e rregullojnë këtë fushë para marrjes së vendimeve fillestare janë ndër shkaktarët e kësaj gjendje.

##### **Ndikimi**

Ushtrimi i detyrës së drejtorit të auditimit të brendshëm nga punonjësi i cili me vendim është sistemuar në pozitë tjetër menaxheriale mund të ndikojë në pavarësinë e procesit të AB dhe në konfliktin e detyrave në mes dy pozitave (formale dhe jo formale).

##### **Rekomandimi A1**

Drejtori i Përgjithshëm në koordinim me Ministrin e Financave duhet të sigurojnë zgjidhje efektive në mënyrë që detyrat të ushtrohen në përputhje me vendimet/aktemerimet për të cilën janë emëruar zyrtarët brenda ATK-së.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>12,889,622</b>	<b>12,611,543</b>	<b>12,574,959</b>	<b>12,782,571</b>	<b>11,069,477</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	12,889,622	12,611,543	12,574,959	12,655,956	11,069,477
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	126,615	0

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 278,079€. Kjo ulje është si rezultat i reduktimit të buxhetit me rishikim dhe ndryshimeve buxhetore me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2021, ATK ka shpenzuar 99% të buxhetit përfundimtar ose 12,574,959€ me një rritje prej 6% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>12,889,622</b>	<b>12,611,543</b>	<b>12,574,959</b>	<b>12,782,571</b>	<b>11,069,477</b>
Pagat dhe mëditjet	8,407,856	7,679,935	7,678,023	7,748,931	7,455,035
Mallrat dhe shërbimet	1,720,070	2,271,607	2,245,966	2,057,739	2,320,511
Komunalitë	361,696	154,406	147,066	134,626	150,906
Subvencionet dhe transferet	0	12,000	10,316	0	0
Investimet Kapitale	2,400,000	2,493,596	2,493,587	2,841,275	1,143,026


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje kishte pësuar ndryshime në krahasim me buxhetin fillestar, duke qenë më i ulët për 727,921€. Zvogëlimi kishte ndodhur si rezultat i mos rekrutimit të stafit sipas strukturës organizative të ATK-së;

- Buxheti final i mallrave dhe shërbimeve dhe komunalive ishte rritur për 344,247€ kjo si rezultat i rishikimit buxhetor dhe pastaj edhe i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore;
- Buxheti final i subvencioneve dhe transfereve ishte 12,000€. Me qëllim të pagesës së shpenzimeve për personelin me rastin e vdekjeve të anëtarëve të familjes, ATK kishte bërë transferin e mjeteve nga kategoria mallra dhe shërbime në subvencione dhe transfere, dhe nga kjo vlerë ishin shpenzuar 10,316€; dhe
- Buxheti final për shpenzimet kapitale ishte 2,493,596€, prej tyre ishin shpenzuar 2,493,587€ apo 100%. ATK për vitin 2021 nuk kishte paraparë të realizonte projekte të reja, shpenzimet e bëra ishin për 8 projekte që ishin vazhdim i viteve të mëhershme.

Në kuadër të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, ishin të përfshira edhe shpenzimet e Covid-19 në vlerë prej 13,929€, të cilat kishin të bënin me shpenzime të dezinfektimit dhe furnizime higjienike.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat tatimore të planifikuara me Ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021 ishin 520,200,000€. Ndërkaq, me ligjin e rishikuar të buxhetit, vlera e parashikuar e të hyrave tatimore ishte rritur në 556,000,000€.

Nga kjo vlerë, ATK kishte arritur të realizonte 597,702,804€, ndërsa në vlera neto, realizimi ishte 541,632,809€, (të hyrat bruto 597,702,804€ - 56,069,995€ kthimet). Krahasuar me vitin e kaluar, të hyrat bruto në përgjithësi kanë pësuar rritje. Në vitin 2021, realizimi i të hyrave bruto ishte më i lartë për 130,662,971€ apo rreth 28% më shumë se në vitin 2020.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Të hyrat bruto	520,200,000	556,000,000	597,702,804	467,039,833	504,281,904
Kthimet	-41,000,000	-43,400,000	-56,069,995	-31,344,054	-43,719,838
<b>Të hyrat neto</b>	<b>479,200,000</b>	<b>512,600,000</b>	<b>541,632,809</b>	<b>435,695,779</b>	<b>460,562,066</b>

**Tabela 4. Të hyrat/pranimet e realizuara dhe kthimet sipas kategorive ekonomike në tri vitet e fundit (në €)**

Përshkrimi	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
TATIMI I PARAGJYKUAR	202,189	43,894	18
TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR	291,494,508	222,381,488	238,948,260
TVSH - JA E SHTYRË	174,816	117,476	292,142
TAX NË PAGA-MBAJTUR NË BURIM	129,285,474	111,849,166	107,265,196
TATIMI PËR BIZNESE INDIVIDUALE	33,715,593	26,331,442	32,700,309
TATIMI MBI QIRANË E PASURISË SË PATRUPËZUAR	813,997	390,349	464,060
TAT. I MBAJTUR NË BURIM INTERES TE DREJTA PRONËSORË QIRA	25,706,003	19,394,896	25,186,583
TATIMI PËR KORPORATA	113,743,401	85,235,491	94,593,409
KONTO KALUESE - ADMINISTRATA TATIMORE	16,402	29,999	29,628
TE HYRAT NGA GJOBAT E ATK-ËS	2,423,816	1,264,043	4,742,900
LICENCA PËR LOJËRA	0	0	56,769
TË HYRAT - SHITJA E MBETURINAVE	76,312	72	90
TË HYRAT SHITJA E MALLRAVE TE KONFISKUAR	29,293	1,476	2,512
REGJISTRIMI I PENGUT	0	40	29
TË HYRAT NGA VITI I KALUAR	21,000	0	0
<b>Totali i pranimeve bruto:</b>	<b>597,702,804</b>	<b>467,039,833</b>	<b>504,281,904</b>
KTHIM - TATIMI I PARAGJYKUAR	0	0	-17,179
KTHIM - TATIMI NË FITIM	0	0	-7,993

KTHIMI I TVSH-ËS	-53,005,138	-30,325,348	-39,029,345
KTHIM-TAX NË PAGA-MBAJTUR NË BURIM	-243,725	-348,815	-602,088
KTHIM - TATIMI PËR BIZNESE	-109,971	-105,078	-174,063
KTHIM - QIRA FITIM LOTO DREJT	-349	-49,090	-133,586
KTHIM - TATIM PËR KORPORATA	-2,707,062	-513,722	-3,755,334
KTHIM - TE HYRAT - GJOBAT E ATK-ËS	-3,750	-2,000	-250
<b>Totali i kthimeve:</b>	<b>-56,069,995</b>	<b>-31,344,054</b>	<b>-43,719,838</b>
<b>Totali i pranimeve neto (pranimet bruto – kthimet):</b>	<b>541,632,809</b>	<b>435,695,779</b>	<b>460,562,066</b>

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të ATK-së ka rezultuar në pesë (5) rekomandime. ATK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, tri (3) rekomandime janë zbatuar dhe dy (2) nuk ishin adresuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 5 (ose Tabelën e rekomandimeve).

(Vëni re se kur ceket fundi i auditimit, i referohemi fundit të procesit të auditimit - deri në momentin kur e dërgojmë raportin e këtij viti).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




Tabela 5 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që planifikimi dhe realizimi i pagesave të bëhet në kategoritë ekonomike të duhura për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël.	Gjatë auditimit të vitit 2021 nuk kishte keq klasifikim	I zbatuar
2.	Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha bizneset të cilat i plotësojnë kriteret për fiskalizim do të pajisen me pajisjet elektronike fiskale (PEF) konform kërkesave ligjore.	Përkundër përpjekjeve të bëra nga ATK fiskalizimi i plotë i të gjitha bizneseve që i plotësojnë kriteret mbetet sfidë. Numri I bizneseve që nuk janë fiskalizuar, ishte pothuajse identik me vitin 2021.	Nuk është adresuar
3.	Pasuritë	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontrollë efektive në regjistrimin e pasurive dhe raportimin e tyre në PFV, në mënyrë që të mundësohet regjistër i plotë i pasurisë dhe raportim i drejtë në PFV.	ATK gjatë vitit 2021 kishte regjistruar të gjitha pasuritë kapitale, kishte bërë inventarizimin dhe në bazë të raportit të inventarizimit ka bërë vlerësimin shitjen dhe tjetërsimin e pasurive të vjetra.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Drejtori i Përgjithshëm në koordinim me zyrtarë të MAP-it, duhet të sigurojë që janë ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme dhe të monitoroj nga afër funksionalizimin e sistemit e-pasuria, në mënyrë që të sigurohet se pasuritë jo kapitale dhe stoqet regjistrohen dhe menaxhohen përmes këtij sistemi. Po ashtu, duhet të sigurojë që komisioni pas përfundimit të raportit të inventarizimit të bëjë harmonizimin e tij me regjistrat e pasurisë, para përgatitjes së PFV-ve me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen reale të pasurive me të cilat disponon organizata. Në rastet kur është e nevojshme, duhet të bëhet edhe vlerësimi i pasurisë bazuar në raportin e inventarizimit.	ATK edhe gjatë vitit 2021 nuk kishte funksionalizuar softuerin e-pasuria (kjo çështje është shpalosur te theksimi i çështjes. Pasuritë jo kapitale dhe stoqet mbahen në një regjistër të brendshëm (excel) dhe ishin të sakta dhe të plota. Përderisa ATK kishte bërë harmonizimin e raportit të inventarizimit dhe regjistrin e pasurisë.	I zbatuar
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime më efektive në inkasimin e këtyre borxheve. Për më tepër, përpjekje shtesë nevojiten në trajtimin e stokut të borxheve të vjetra bazuar në kërkesat ligjore përkatëse.	Përkundër përpjekjeve në mbledhjen e borxheve, vlera e stokut të borxheve të vjetra dhe të pa mbledhshme mbetet ende e lartë.	Nuk është adresuar



Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndhimëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Arta Kryeziu, Udhëheqëse e ekipit






Aida Podrimaj, Anëtare e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

 <p style="text-align: center;"> <b>Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo</b>          Qeveria - Vlada - Government          Ministria e Financave, Punës dhe Transferimeve - Ministarstvo Financija, Rada i Transfera          Ministry of Finance, Labour and Transfers          Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo       </p>		
DATE/A:	24/05/2022	
REFERENC-Ë/	KORRIK 2021	
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Kombëtare të Auditimit	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ilir Murtezaj – Drejtor i Përgjithshëm në ATK-së	
NGA/OD/FROM:	Hamit Mulaj – z.v. Drejtor i Përgjithshëm në ATK-së	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJEC	Letër konfirmimi për pranimin e draft raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare të ATK-se për vitin 2021	

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- ATK ka pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Administratës Tatimore të Kosovës, për vitin 2021 me datën: 24.05.2022.
- Bazuar në gjendjen e paraqitur në draft raport shihet se qasja e ekipit të Auditimit ka qenë profesionale dhe ka trajtuar të gjitha çështjet në mënyrë parimore, duke analizuar të gjitha aktivitetet e ATK-se, si dhe prezantimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2021.
- Lidhur me të gjeturat e prezantuar në draft raport pajtohem, me përjashtim të vlerësimit të rasti i llogarive të arkëtushme ku potencohet si rekomandim i pa zbatuar, mendojmë se ky është një proces i vazhdueshëm dhe për kundër përpjekjeve tona të vazhdueshme për përbushjen në plotni, ky është një proces i vazhdueshëm që asnjëherë nuk mundet të realizohet i tëri dhe në pa mundësi të realizimit 100 %, mendoj se vlerësimi duhet të jetë rekomandim në vijim, sepse gjithmonë bëjmë përpjekje që të realizohet gjë që potencohet edhe në draft raport progresi i arritur në krahasim me vitin paraprak, por është proces kompleks dhe natyra e realizimit varet edhe nga shumë faktorë të cilat na bëjnë të pamundur realizimin e 100 %.
- Ju njoftojmë se brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup>
- <sup>5</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.